



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 6 të Rregullores Nr.03/2020 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datën 27 nëntor 2020, shpallet ky:

KONKURS I BRENDSHËM

I. Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

- 1. Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve – një (1) kryes të punëve;**
Numri i referencës: DDÇJM/ZKA/15-11/20
- 2. Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit – një (1) kryes të punëve;**
Numri i referencës: UNjP/ZKA/16-11/20
- 3. Specialist për sistemin elektronik të menaxhimit të auditimit – një (1) kryes të punëve.**
Numri i referencës: SSEMA/ZKA/17-11/20

II. Kohëzgjatja e emërimit:

Në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve, kandidati i përzgjedhur emërohet me mandat prej pesë (5) vitesh;

Në dy pozitat tjera me nr.2 dhe 3, kandidatët e përzgjedhur emërohen për afat të pa caktuar.

III. Të gjitha informatat tjera relevante për pozitat e punës sipas pikës I. gjenden në Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

IV. Vendet e punës janë në selinë e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Prishtinë.

V. Detyrat dhe përgjegjësitë themelore

Detyrat dhe përgjegjësitë themelore janë përcaktuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe përshkrimin e detyrave të punës.

Përshkrimin e detyrave, së bashku me këtë konkurs e gjeni në faqen e internetit të ZKA-së “Mundësi Punësimi”.

VI. Kualifikimet e kërkuara:

1. Për pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve, kërkohen:

- 1.1. Diplomë fakulteti në shkencat juridike;
- 1.2. Përvojë pune profesionale prej shtatë (7) vitesh, prej tyre tri (3) menaxheriale.

2. Për pozitën e punës Udhëheqës i Njesisë së Prokurimit, kërkohen:

- 2.1. Diplomë fakulteti përkatës;
- 2.2. Përvojë pune profesionale prej shtatë (7) vitesh; dhe
- 2.3. Çertifikimi sipas legjislacionit në fuqi.

3. Për pozitën e punës Specialist për sistemin elektronik të menaxhimit të auditimit, kërkohen:

- 3.1. Diplomë fakulteti në fushën e inxhinierisë së softuerit apo në shkencat kompjuterike;
- 3.2. Përvojë pune profesionale prej shtatë (7) vitesh në menaxhim, zhvillim, analizë, integrim ose zbatim të sistemeve softuerike; dhe
- 3.3. Njohuri e gjuhës angleze.

VII. Shkathtësit e kërkuara:

Kandidatët duhet të kenë shkathtësitë përkatëse për pozitat e caktuara, përkatësisht sipas atyre që janë përcaktuar me aktin për përshkrimin e detyrave për vendet përkatëse të punës.

Procedura e Konkurrimit:

Formularin e konkurrimit kandidatët mund ta marrin në recepcionin e objektit të Zyrës Kombëtare të Auditimit ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari konkurrues dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005;

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për konkurrim.

Dokumentet si më poshtë, nëse janë pjesë e dosjes personale, nuk dorëzohen me formularin për konkurrim, përveç dokumenteve të tjera shtesë të cilat mund t'i dorëzoni bashkë me formularin për konkurrim.

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi;

Vetëm formulari zyrtar i konkurrimit do të merret parasysh. Formularët e konkurrimit të dorëzuar pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen.

Kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara do të informohen, gjithashtu kandidatët e të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës për plotësimin e vendeve të lira të punës.

Konkursi është i hapur 5 ditë pas ditës së publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZKA-së dhe në tabelen e shpalljeve zyrtare, duke filluar nga data 28.11.2020, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 02.12.2020, ora 16.00.